

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

17 Shkurt, 2021

Të dashur Familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Unë e di se shumë prej jush janë të kënaqur për kthimin e fëmijës tuaj në shkollë në – person javën e ardhshme. Sidoqoftë, po shkruaj për të dhënë lajmin që, për shkak të ndërmjetësimit të vazhdueshëm të palëve të treta të kërkuar nga Federata e Mësuesve të Filadelfias, fillimi i planeve tona për të filluar ngadalë dhe të sigurtë shkallëzimin e studentëve dhe personelit në shkollat tona do të vonohet një javë. **Tani planifikojmë të fillojmë të mirëpresim studentët të Hënën, 1 Mars, duke filluar me studentët PreK-2, familjet e të cilëve zgjedhën mësimin hibrid në vjeshtë.**

Si prindër dhe kujdestarë ju e dini shumë mirë që shumë nga studentët tanë po luftojnë shoqërisht, emocionalisht dhe akademikisht pasi u angazhuan me mësuesit dhe bashkëmoshatarët e tyre përmes një ekrani kompjuteri për gati një vit. Kthimi në mënyrë të sigurtë i fëmijëve tanë në shkollat e tyre në faza është një hap thelbësor për të ndihmuar në rivendosjen e ndjenjës së komunitetit dhe lidhjes që kaq shumë studentët tanë duan dhe kanë nevojë.

Tani për tani, me masa të gjera të sigurisë në vend, unë besoj fuqimisht se shkollat tona janë të gatshme të fillojnë të mirëpresin personelin dhe studentët për të mësuar në - person.

Që nga Marsi, mijëra anëtarë të Drejtorisë kanë punuar në shkolla për t'i përgatitur ato për mësim të sigurt në - person.

- Ne kemi njoftuar planet e testimit të shpejtë për studentët dhe personelin dhe fillimin e disponueshmërisë së vaksinave të COVID-19 për mësuesit dhe personelin tjetër si dy masa shtesë të sigurisë në planin tonë të shëndetit dhe sigurisë.
- Ne kemi investuar 65 milion dollarë në pajisje mbrojtëse personale për studentët dhe personelin, stacione për pastrimin e duarve, ndarje pleksiglas, riparime ventilimi dhe përmirësime për rrjedhën e ajrit të freskët, sinjale distancuese sociale dhe masa të tjera sigurie që janë provuar se mbajnë të ulët nivelin e transmetimit të virusit në shkolla. Kjo është përveç 250 milion dollarë për të adresuar plumbin dhe asbestin, dhe për të bërë përmirësime të tjera.

Unë dua të bëj të qartë se unë do të vazhdoj të punoj në bashkëpunim për të gjetur gjuhë të përbashkët në mënyrë që të mund të hapim me siguri sa më shumë shkolla sa më shpejt të jetë e

mundur dhe të ndihmojmë fëmijët dhe familjet tona të shkojnë përpara nga shumë pasoja tragjike të kësaj pandemie.

Sinqerisht,

A handwritten signature in black ink that reads "William R. Hite Jr." followed by a stylized flourish.

William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias